



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Ref: 1509/1098/BA/dk

## VENDIMI I BORDIT PËR ANKESA

në çështjen e Ankesës nga

Top Kosova Radio

(“Palë Ankuese”)

Znj. Mirlinda Kadriu

kundër vendimit të  
Komisionit të Pavarur për Media

(“KPM”)

në Ankesën 2015/156  
(Vendimit të KPM-së të datës 29 qershor 2015)

### Faktet

1. Me vendimin e tij 2015/159 të datës 29 qershor 2015 (Ref: 1506/844/KPM/am) Komisioni i KPM-së shqiptoj gjobën prej 1000 (njëmijë) euro kundër Palës Ankuese për shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
2. Bordi për Ankesa gjen se KPM bazuar në vizitën e bërë në teren me datën 2 mars 2015, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Ankuese me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, në mënyrë të drejtë ka konstatuar se Pala Ankuese nuk është duke transmetuar nga lokacioni për të cilin është licencuar nga KPM-ja, në koordinatat N42° 40' 08.0", E21° 10' 39.1", duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
3. Bordi për Ankesa bazuar në raportin e monitorimit të datës 8 prill 2015, të bërë Departamenti për Menaxhimi Frekuencor, dhe letrën përmes të cilës është kërkuar nga Pala Ankuese që në afat prej shtatë (7) ditësh ta kthejë transmetuesin në pikën për të cilën është licencuar nga KPM, me qëllim që të veprojë në pajtim me parametrat teknik të përcaktuar me pjesën 2 dhe 4 të Licencës, gjen se Pala Ankuese është njoftuar për shkeljen e bërë dhe se nga kjo e fundit është kërkuar të kthejë transmetuesin në pikën e licencimit.



4. Bordi për Ankesa gjen se KPM, me datën 17 prill 2015, ka pranuar një përgjigje nga Pala Ankuese, në të cilën sqaron se arsyeja e ndërrimit të lokacionit të pajisjeve është bërë për shkak të rrezatimit që ka pasur dhe ankesave të banorëve. Bordi për Ankesa gjen se Pala Ankuese nuk kishte aprovim nga KPM-ja për ndryshimin e vendndodhjes së transmetuesit.
5. Bordi për Ankesa gjithashtu gjen se Pala Ankues edhe përkundër njoftimit të datës 8 prill 2015, ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, duke mos e kthyer transmetuesin në pikën e transmetimit për të cilën është licencuar nga KPM-ja.

#### Vendimi

6. -Bordi për Ankesa, pas shqyrtimit të argumenteve të paraqitura nga KPM dhe Pala Ankuese konstatoi se, Vendimi i Komisionit të KPM-së është marr në pajtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, Ligjin e KPM-së dhe gjendjen faktike të konstatuar në teren.
7. Bordi për Ankesa, duke u bazuar në faktin se KPM ka bërë vlerësim të drejtë të ligjit material, procedural dhe vlerësim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në pajtim me nenin 36, paragrafi 3, të Ligjit të KPM-së vërteton Vendimin e KPM-së Nr 2015/156, si të drejt dhe të ligjshëm.

#### Arsyetimi

8. Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datë 27 gusht 2015, ka bërë shqyrtimin dhe analizimin e të gjitha fakteve, shkresave të lëndës përfshirë këtu të gjitha raportet e monitorimit dhe shkresën përmes së cilës është kërkuar nga Pala Ankuese të kthej transmetuesin në vendin e licencimit.
9. Bordi për Ankesa, bazuar në raportin e monitorimit përmes të cilit është konstatuar gjendja në teren, gjen se Palës Ankuese, ka vepruar në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, duke ndryshuar vendndodhjen e transmetuesit pa aprovim paraprak të KPM-së, duke shkelur nenin 6, paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
10. Bordi për Ankesa pas analizimit të raporteve të monitorimit dhe shkresave të tjera të lëndës gjen se Pala Ankuese edhe përkundër Shkresës së datës 8 prill 2015, vazhdon të veprojë në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës i cili përcakton se:


*“Përveç dispozitave për transferimin e pronësisë të specifikuar në Nenin 5.0, i Licencuari mund të bëjë kërkesë për ndryshimet e specifikuar në paragrafet e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Përhapjes Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit, duke ia bërë me shkrim kërkesën për këto ndryshime KPM-së. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm me miratim paraprak me shkrim nga ana e KPM-së”.*




11. Bordi për Ankesa konstaton se Pala Ankuese është e obliguar të respektoj të gjitha detyrimet të cilat rrjedhin nga licenca, duke filluar prej respektimit të Ligjit të KPM-së dhe të gjitha aktet nënligjore.

**Rishikim procedural**

12. Vendimet e bordit janë përfundimtare në pajtim me nenin 44.2 të Ligjit për KPM-në.
13. Palët në vendim mund të dorëzojnë kërkesën për rishikim procedural në Gjykatë Supreme të Kosovës në pajtim me ligjin e aplikueshëm.
14. Inicimi i rishikimit procedural nuk ndalon zbatimin e vendimeve të Komisionit të KPM-së ashtu siç mbështeten apo modifikohen nga Bordi.

  
Daut KRASNIQI  
Kryetar, Bordi për Ankesa



27.08.2015  
data

Lloji i dërgesës \_\_\_\_\_  
Vista postiljke \_\_\_\_\_ 1098

Vlera e cekur - Shuma e dërguar \_\_\_\_\_  
Oznaçona vlerdost - postiani iznos \_\_\_\_\_

nën numër \_\_\_\_\_  
pod br. \_\_\_\_\_

për \_\_\_\_\_  
za \_\_\_\_\_  
TAP KOSOVA RADIO - NIKLINDA KADRIC  
ZONA INDUSTRIAKE - PRITINE

(Vendi)  
(Mesto)

Posthtë i nënshkuarti deklarom që dërgesa e cekur (shuma e dërguar) është dorëzuar në rregull (paguar me datë) \_\_\_\_\_  
Dole potpisanî izjavljuje da je pomenuta pošiljka (postiani iznos) predata uredno (placena dana)

Nëshkrimi i marrësit  
Potpis primaoca

Vula e postës së vendit  
Peçat poste

Nëshkrimi i nënpunësit  
të postës së vendit  
Potpis radnika poste



